



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në bazë të neneve 3.1, 3.4, 15.1 pikat (a), (c), (f), (j), 21.2, 78, 79, 80 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit dhe ofrimit të Telekomunikacionit Aeronautik në Republikën e Kosovës në përputhje me standardet dhe praktikat e rekomanduara të përcaktuara në Shtojcën 10 në Konventën Ndërkombëtare mbi Aviacionin Civil.

Pasi ka përfunduar procesin e konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

## **RREGULLORE NR. 2/2016 PËR ZBATIMIN E SHTOJCES 10 NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE MBI AVIACIONIN CIVIL PËR TELEKOMUNIKACIONIN AERONAUTIK**

### **Neni 1 Fusha e zbatimit**

1.1 Kjo Rregullore përcakton kërkesat për ofrimin e Telekomunikacionit Aeronautik, në përputhje me Standardet dhe Praktikën e Rekomanduara (SPR) përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të përcaktuara në Aneksin 10 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

1.2 Ofrimi i Telekomunikacionit Aeronautik në Republikën e Kosovës, do të qeveriset nga SPR të Aneksit 10 me Vëllimet I, II, III, IV, V, të gjitha Shtojca dhe Shtesat siç janë të publikuara në Edicionin e Gjashtë Korrik 2006 për Vëllimin I, Edicionin e Gjashtë Tetor 2001 për Vëllimin II, Edicionin e Dytë Korrik 2007 për Vëllimin III, Edicionin e Pestë Korrik 2014 për Vëllimin IV dhe Edicionin e Tretë Korrik 2013 për Vëllimin V të publikuara nga ONAC.

## **Neni 2**

### **Zbatimi i SPR-ve**

2.1 Aneksi 10 me Vëllimet I, II, III, IV dhe V mbi Telekomunikacionit Aeronautik, siç është përcaktuar sipas nenit 1 paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje do të jenë të zbatueshme në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2.2 SPR të zbatueshme të specifikuara në Aneksin 10 për Telekomunikacionit Aeronautik si dhe Shtojcat dhe shtesat e saj do të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

## **Neni 3**

### **Termet dhe Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje termet “Shtet Kontraktues”, “Shteti” drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përdorura në njëjës apo në shumës në Aneksin 10 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, siç përcaktohet më sipër në nenin 1, paragrafi 2, do të lexohen si “Republika e Kosovës”.

## **Neni 4**

### **Disponueshmëria**

SPR-të e Aneksit 3, siç është specifikuar në nenin 1, paragrafi 2, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, i bashkëngjiten kësaj Rregulloreje si Shtojca 1.

## **Neni 5**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 shkurt 2016.

Prishtinë, 5 shkurt 2016

**Dritan Gjonbalaj**  
**Drejtore i Përgjithshëm**